



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Institutin e Krimeve të kryera gjatë Luftës në Kosovë.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrje të Kosovës në "Fiscalis", Programi i Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Fushën e Tatimit.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrje të Kosovës në "Doganat", Programi i Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Fushën e Doganave.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Prokurorin e Shtetit.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Prokurorinë Speciale.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Sigurinë Kibernetike.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Tubimet Publike.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për Projektin Parku i Inovacionit dhe Trajnimit Prizren (PIT) ndërmjet Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Republikës Federale të Gjermanisë përfaqësuar nga GIZ.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/96

Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore Kompania për Menaxhimin e Deponive, Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Avni Ramadani kryesues;
 - 1.2. Znj. Mirlinda Ahmeti anëtare;
 - 1.3. Znj. Zoge Spahiu, anëtare;
 - 1.4. Znj. Lindita Toçi, anëtare;
 - 1.5. Z. Bashkim Pllana, anëtar;
 - 1.6. Z. Goran Lazić, anëtar.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/96
Datë: 14.09.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, bazuar në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2022 për Komisionin e Ankesave për të Huajt, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni i Ankesave për të Huajt në këtë përbërje:
 - 1.1. Qendrim Bytyqi, Ministria e Punëve të Brendshme – kryesues;
 - 1.2. Arsim Beqiri, Ministria e Drejtësisë – zëvendëskryesues;
 - 1.3. Rejhane Jusufi, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – anëtare;
 - 1.4. Bahrije Berisha, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – anëtare;
 - 1.5. Besiana Hyseni, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – anëtare.
2. Mandati i Komisionit është tre (3) vjet dhe është i pavarur në punën e tij.
3. DShAM/MPB luan rolin e Sekretariatit të Komisionit dhe të njëjtit i ofron kushte teknike për ushtrimin e përgjegjësisë.
4. Komisioni gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisë e zbaton Ligjin në fuqi për të Huajt dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, Ligji në fuqi për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe legjislacionin tjetër i cili është relevant në ushtrimin e përgjegjësisë së Komisionit.
5. Obligohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë të përmendura në pikën 1. të këtij Vendimi për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohen Vendimet e Qeverisë Nr. 15/50 i datës 23 dhjetor 2021 dhe Nr. 10/84 i datës 22 qershor 2022.

7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 50 (2) dhe 52 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:


V E N D I M

1. Themelohet Autoriteti Qeveritar për Migrim (në tekstin e mëtejme "AQM") i cili funksionon si mekanizëm këshillëdhënës në fushën e migrimit, përmes hartimit të dokumenteve të politikave dhe analizave, bazuar në të dhëna në fushën e migrimit.
2. Autoriteti nga pika 1. e këtij Vendimi funksionon si trup i përhershëm qeveritar, me përbërje nga:
 - 2.1. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim - Ministria e Punëve të Brendshme, Kryesues/e;
 - 2.2. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinimin e Politikave - Ministria e Punëve të Brendshme, zv. Kryesues/e;
 - 2.3. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Statistika - Banka Qendrore, anëtar/e;
 - 2.4. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Diasporë - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar/e;
 - 2.5. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Çështje Konsullore - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar/e;
 - 2.6. Përfaqësuesi/ja nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar/e;
 - 2.7. Përfaqësuesi/ja nga Agjencia e Statistikave - Zyra e Kryeministrit, anëtar/e;
 - 2.8. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinimin e Politikave - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar/e;
 - 2.9. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve - Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar/e;
 - 2.10. Përfaqësuesi/ja nga Zyra për Planifikim Strategjik - Zyra e Kryeministrit, anëtar/e;
 - 2.11. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Integrim Evropian, Koordinim të Politikave dhe Çështje Ligjore - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar/e;
 - 2.12. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave - Ministria e Shëndetësisë, anëtar/e;
 - 2.13. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, anëtar/e;

- 2.14. Përfaqësuesi/ja nga Agjencia për Promovimin e Investimeve dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, anëtar/e;
 - 2.15. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Integrim Evropian, Koordinim të Politikave dhe Zhvillim Ekonomik - Ministria e Ekonomisë, anëtar/e;
 - 2.16. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Menaxhim dhe Koordinim të Projekteve - Ministria për Kthim dhe Komunitete, anëtar/e;
 - 2.17. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti i Kufirit - Policia e Kosovës, anëtar/e;
 - 2.18. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti i Hetimeve - Policia e Kosovës, anëtar/e;
 - 2.19. Përfaqësuesi/ja nga Sekretariati i Strategjive - Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar/e;
 - 2.20. Përfaqësuesi/ja nga Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar/e;
 - 2.21. Përfaqësuesi/ja nga Zyra për Kriteria Politike - Zyra e Kryeministrit, anëtar/e;
 - 2.22. Përfaqësuesi/ja nga Agjencia e Regjistrimit Civil - Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar/e.
3. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në Ministrinë e Punëve të Brendshme, shërben si Sekretariat i AQM-së.
 4. Detyrat dhe përgjegjësitë e AQM-së janë:
 - 4.1. Ofron këshilla për Koordinatorin Shtetëror për Migrim;
 - 4.2. Harton Profilet e Migrimit;
 - 4.3. Harton Strategjinë për Migrim dhe Planin e Veprimit dhe monitoron zbatimin;
 - 4.4. Ofron ekspertizë në fushën e migrimit për institucionet qeveritare gjatë procesit të hartimit të politikave sektoriale;
 - 4.5. Monitoron, vlerëson dhe raporton nivelin e zbatimit të politikave në fushën e migrimit;
 - 4.6. Inicion, zhvillon, autorizon dhe mbikëqyr hulumtimet e nevojshme në fushën e migrimit;
 - 4.7. Mbledh dhe analizon të dhëna për hartimin e rekomandimeve dhe politikave në fushën e migrimit;
 - 4.8. Lehtëson bashkëpunimin dhe koordinimin ndër-institucional në fushën e migrimit;
 - 4.9. Komunikon dhe bashkëpunon me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare që lidhen me aktivitetet dhe mbështetjen për migrimin;
 - 4.10. Merr pjesë në aktivitete dhe iniciativa në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e migrimit;
 - 4.11. Në rast të situatave të krizave që kanë të bëjnë me migrimin, azilin dhe refugjatët, Autoriteti Qeveritar për Migrim do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet kompetente për menaxhimin e lëvizjeve migratore.
 5. Të gjithë akterët e përfaqësuar direkt apo indirekt në kuadër të AQM janë të obliguar të ndajnë të dhënat statistikore me Sekretariatit e AQM-së në periudha të caktuara kohore apo me kërkesë të Kryesuesit të AQM-së.
 6. Me qëllim të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi të caktuara me pikën 4. të këtij Vendimi, Kryesuesi/ja i/e AQM-së mund të themelojë grupe tematike të punës.

7. Në takimet e AQM-së, varësisht nga çështjet që diskutohen, Kryesuesi mund të ftojë edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, botës akademike, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe donatorët e tjerë relevantë.
8. AQM brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi nxjerr Udhëzuesin për Funkcionimin e Brendshëm të AQM-së, duke përfshirë edhe hartimin e planeve vjetore të punës.
9. Obligohen të gjitha institucionet dhe organet e cekura në këtë Vendim për zbatimin e këtij Vendimi.
10. Obligohen të gjitha institucionet që sipas nevojës dhe fushë së përgjegjësisë së tyre administrative t'i ofrojnë ndihmë AQM-së në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të saj.
11. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 08/158 i datës 29 nëntor 2013.
12. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14 korrik 2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25 gusht 2021 me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17 dhjetor 2021, me Vendimin Nr. 15/62 të datës 23 shkurt 2022, ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 04/90 të datës 26 korrik 2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për ndarje të mjeteve buxhetore në vlerë prej 2,610,100 € (dy milionë e gjashtëqindëdhjetë mijë e njëqind euro), në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14 korrik 2021, i ndryshuar dhe plotësuar lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, në kuadër të masës 4.1-Mbështetja e Shëndetësisë, në formën si në vijim:
 - 1.1. Shuma prej 1,490,000 € (një milion e katërqindëntëdhjetë mijë euro) ndahet në Ministrinë e Shëndetësisë me kod 206, në nën-programin "Aftësimi Specialistik dhe EVM" me kod 90300, në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe Shtesa", për pagat e specialistëve të rregullt për periudhën shtator-dhjetor 2022; dhe
 - 1.2. Shuma prej 1,120,100 € (një milion e njëqind e njëzetë mijë e njëqind euro) ndahet në Ministrinë e Shëndetësisë me kod 206, në nën-programin "Aftësimi Specialistik dhe EVM" me kod 90300, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për pagat e specialistëve me vet-financim për periudhën shtator-dhjetor 2022.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) të organizata buxhetore dhe programit përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Shëndetësisë, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr.09/69 për ndalimin e përkohshëm të eksportit dhe riekportit të produkteve themelore agro-ushqimore, i datës 13 prill 2022.
2. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Nisur nga përmirësimi i situatës me furnizim me produkte esenciale ushqimore në tregun e Republikës së Kosovës, lehtësimet në furnizimin me lëndë të parë për sasi të kontraktuara nga bizneset vendore; nënshkrimin e marrëveshjeve për furnizim me produkte të vajit me prodhuesit vendor nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përfshirë pranimin e Letër Zotimit të datës 22 gusht 2022 nga Shoqata e Mullisëve të Kosovës për furnizim me grurë vendor dhe nga importi drejtuar Ministres së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e në veçanti me qëllim që të mos kenë humbje bizneset prodhuese në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 paragrafi 3. të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej: 374,232.00, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me kod 212, nën programi Administrata Qendrore me kod 11312, nga kategoria e shpenzimeve kapitale konkretisht nga projekti: "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal" me kod 15633 në 5 (pesë) projekte kapitale në përputhje me 5 (pesë) marrëveshjet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga Ministri i MAPL-së dhe kryetarët e komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi rialokohen nga projekti: "kapital" "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal" me kod 15633 në këto projekte të reja, konform shumave të cekura si në vijim:
 - 2.1. Projekti " Ruajtja dhe trajtimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe krijimi i sigurisë së lëvizjes në Qytetin e Rahovecit", komuna e Rahovecit në vlerë prej 100,000.00 €;
 - 2.2. Projekti " Rregullimi i hapësirave publike në komunën e Lipjanit", komuna e Lipjanit në vlerë prej 79,232.00 €;
 - 2.3. Projekti " Ndërtimi i parkut dhe baseneve rekreative rrëzë Moronicës", komuna e Junikut në vlerë prej 50,000.00 €;
 - 2.4. Projekti "Asfaltimi i rrugës Segmenti Magjistranja Suharekë-Prizren faza e dytë", komuna e Suharekës në vlerë prej 100,000.00 €;
 - 2.5. Projekti "Kanalizimi Fekal Atmosferik në rrugën Optrusha" komuna e Mamushës në vlerë prej 45,000.00 €.
3. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2022, neni 16. pika 3, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30.3, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), me kod 207 për transfer dhe rialokime të mjeteve në shumë prej 2,020,114 (dy milion e njëzetmijënjëqindkatërmbëdhjetë) euro deri nën 25% në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale në total të nën programeve.
2. Mjetet sipas pikës 1 të këtij vendimi merren nga nën programet si në vijim:
 - 2.1. Nga nën programi Përkrahja Institucionale për Kulture me kod 80300 kategoria e shpenzimeve kapitale, në këtë nën program shuma e kërkuar për rialokim e ndarjes së ndikuar negativisht është -15.48%, përkatësisht nga projektet:
 - Muzeu i Artit Bashkëkohor me kod 13073, shumë prej 195,000 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) euro,
 - Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi në Suharekë, me kod 15382, shumë prej 164,300 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind) euro,
 - Qendra Kulturore në Pagarushe me kod 18322, shumë prej 100,000 (njëqind mijë) euro,
 - Renovimi i kulmit të Shtëpisë së Kulturës Hasan Prishtina, Skenderaj, me kod 18719, shumë prej 21,000 (njëzet mijë) euro,
Shuma prej 480,300 euro Rialokohen në projektin: Objekti Teatër dhe Opera Dr.Ibrahim Rugova me kod 06097 euro.
 - 2.2. Arritjet Sportive me kod 80200 shuma e kërkuar për transfer e ndarjes së ndikuar negativisht është -24.98%, përkatësisht mjetet merren nga projektet:
 - Ndërtimi i Palestrës së Sportit në Zahaq të Pejës me kod 14558 në shumë prej 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) euro;
 - Ndërtimi i Stadiumit në Zhur, Prizren me kod 15377 në shumë prej 220,000 (dyqind e njëzet mijë) euro;
 - Renovimi i Stadiumit "Adem Jashari" Mitrovicë me kod 13391 në shumë prej 399,184 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) euro.

2.3. Zhvillimi dhe Përkrahja e Rinisë me kod 80700, në këtë nën program shuma e kërkuar për transfer e ndarjes së ndikuar negativisht është -20.31%, përkatësisht mjetet merren nga projektet:

- Qendra Rinore në Prizren me kod 14025 në shumë prej 150,000 (njëqind e pese dhjete mije) euro;
- Ndërtimi i hapësirës TIA-Teknologji, Inovacion dhe Arte me kod 19001 në shumë prej 50,000 (pese dhjetë mije) euro;
- Qendra multifunkionale në Ferizaj me kod 18373 në shumë prej 45,700 (katër dhjetë e pesë mije e shtatëqind) euro.

2.4. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës me kod 12500, në këtë nën program shuma e kërkuar për transfer e ndarjes së ndikuar negativisht është -24.99%, përkatësisht mjetet merren nga projekti:

- Ndërtimi i ndërtesës së Arkivit Ndër komunal Prizren me kod 18923 në shumë prej 324,930 (treqind e njëzet e katërmijë e nëntëqind e tridhjetë) euro.

3. Mjetet në shumë prej 1,434,700 (një milion, e katërqindetridhjetekatër mijë e shtatëqind) euro nga projektet e cekura më lartë transferohet në nën programin:

3.1 Përkrahja Institucionale për Kulture me kod 80300 kategoria e shpenzimeve kapitale në projektin Objekti Teatër dhe operë Dr. Ibrahim Rugova me kod 06097, dhe:


3.2 Mjetet në shumë prej 105,114 (njëqind e pese mije e njëqind e katërmëdhjetë) euro në Nën programin Mbrojtja Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore me kod 81500 transferohen në këto projekte kapitale:

- Shtëpia tradicionale Ryshyt Kepuska, Gjakove me kod 15677 në shumë prej 10,049 (dhjetëmijë e katër dhjet e nënte) euro;
- Shtëpi banimi Salih Safqi, Prishtinë me kod 18767 në shumë prej 79,242 (shtatëdhjetë e nëntë mije e dyqind e katër dhjetë e dy) euro;
- Kulla e Sylë Tahirsyles me kod 15976 në shumë prej 9,105 (nënte mije e njëqind e pese) euro; dhe
- Shtëpia e Islam Shipolit me kod 15984 në shume prej 6,718 (gjashte mije e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) euro.

4. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hynë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 1. lidhur me nenin 19, paragrafi 2 dhe 3, dhe nenit 43, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 22 i Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet neni 2. paragrafi 2.1. i Vendimit të Qeverisë Nr. 17/92 të datës 10 gusht 2022 dhe emërohet znj. Edona Nahi, Kryesuese e Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Infrakos, Sh. A.
2. E emëruara sipas nenit 1. të këtij Vendimi, shërben në cilësinë e Kryesueses së Bordit të përkohshëm të Drejtorëve, deri në përzgjedhjen e Bordit të rregullt të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike "Infrakos" Sh. A.
3. Ky Vendim është pjesë e Vendimit Nr. 17/92 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 10 gusht 2022.

A R S Y E T I M

Arsyeja e emërimit të Kryesuesit të Bordit të përkohshëm të Drejtorëve të NP, Infrakos Sh. A, bëhet pas dorëheqjes së ish Kryesuesit z. Dukagjin Kastrati i emëruar Kryesues i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve në NP Infrakos Sh. A. me Vendim Nr.17/92 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 10 gusht 2022. Emërimi i pasueses në cilësinë e Kryesueses së Bordit bëhet për arsye të vazhdimit të veprimtarisë së Bordit, i cili ka rolin të zhvillojë dhe aprovojë planin e biznesit që ndikon në zhvillimin e politikave strategjike zhvillimore për ndërmarrjen.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3. të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022, plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
 - 1.1 Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, (17.03.2014), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/878, Nr.2022/880 (03.06.2022), Nr.2022/1270 (21.07.2022), Nr.2022/1354 (04.08.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP të datës 17 mars 2014, amandamentuar me vendimet (CFSP) 2022/883, (CFSP) 2022/885 (03.06.2022), (CFSP) 2022/1272 (21.07.2022), (CFSP) 2022/1355 (04.08.2022);
 - 1.2 Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014 (31.07.2014) lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve destabilizuese të Rusisë lidhur me situatën në Ukrainë, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/879, (03.06.2022), Nr. 2022/1269 (21.07.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP të datës 31.07.2014, amandamentuar me vendimin (CFSP) 2022/884 (03.06.2022), (CFSP) 2022/1271 (21.07.2022) dhe (CFSP) 2022/1313 (26.07.2022).
 - 1.3 Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 765/2006 lidhur me situatën në Bjellorusi dhe përfshirjen e Bjellorusisë në agresionin Rus kundër Ukrainës, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/876, Nr. 2022/877 (03.06.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2012/642/CFSP (15.10.2012), amandamentuar me vendimin (CFSP) 2022/881 dhe (CFSP) 2022/888 (03.06.2022).
 - 1.4 Vendimit të Këshillit 2014/386/CFSP, lidhur me masat shtrënguese në përgjigje të aneksimit të paligjshëm të Krimesë dhe Sevastopolit, nga Federata Ruse, amandamentuar me vendimin (CFSP) 2022/962 (20.06.2022).

2. Të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1, konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Masat shtrënguese do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Njohjen Reciproke të Patentë Shoferëve.
2. Autorizohet Ministria e Punëve të Brendshme të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Programi i Evropës Dixhitale për periudhën 2021-2027" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë që të zhvilloj negociata me Bashkimin Evropian me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 23/96
Datë: 14.09.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ekzekutiv për Shëndetësi, me qëllim të ndërtimit e koordinimit më të mirë të politikave, e avancimit të shërbimeve.
2. Anëtarët e përhershëm të Komisionit Ekzekutiv janë:
 - 2.1. Kryeministri, kryesues;
 - 2.2. Ministri i Shëndetësisë, anëtar;
 - 2.3. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 2.4. Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtare;
 - 2.5. Zëvendësministrja e Shëndetësisë, anëtare;
 - 2.6. Zëvendësministri i Shëndetësisë; anëtar;
 - 2.7. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, anëtar;
 - 2.8. Këshilltari i Kryeministrit për Shëndetësi, anëtar;
 - 2.9. Këshilltari i Kryeministrit për Teknologji të Informacionit, anëtar;
 - 2.10. Zëvendësuese e drejtorit të ShSKUK-së, anëtare; dhe
 - 2.11. Kryetarja e Bordit të ShSKUK-së, anëtare;
3. Përgjegjësitë e Komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi janë:
 - 3.1. Analiza dhe definimi i ndarjes dhe bashkëpunimit publiko-privat në shëndetësi;
 - 3.2. Zhvillimi i sistemit informativ në shëndetësi, me theks në atë për sigurimet shëndetësore;
 - 3.3. Reformimi i ShSKUK-së përmes fuqizimit të QKUK-së dhe spitaleve rajonale;
 - 3.4. Zhvillimi i sektorit publik të shëndetësisë në kuptim të ngritjes së kapaciteteve të shërbimit e kujdesit shëndetësor dhe ndërlidhjes me studimin e punën universitare dhe shkencore;
 - 3.5. Themelimi i Spitalit Rajonal të Prishtinës.
 - 3.6. Ndërveprimi me pesë odat e profesionistëve shëndetësorë: të mjekëve, të infermierëve, të stomatologëve, të farmacistëve dhe të fizioterapeutëve.
4. Komisioni Ekzekutiv, mund të themelojë grupe punuese për trajtimin e çështjeve specifike të domosdoshme, në qëllim të përmbushjes së përgjegjësisve nga pika 3. e këtij Vendimi.

5. Kryesuesi mund të ftojë për pjesëmarrje Ministra tjerë apo anëtarë tjerë të kabineteve politike dhe nëpunës tjerë të lartë civilë, sipas nevojës.
6. Në cilësinë e pjesëmarrësve të Komisionit Ekzekutiv, pa të drejtë vote, mund të marrin pjesë edhe ekspertët dhe përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare e donatorë tjerë, me kërkesë të Kryesuesit.
7. Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash të anëtarëve me të drejtë vote. Anëtarët me të drejtë vote janë të gjithë anëtarët e përhershëm të Komisionit.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 24/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021 me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, me Vendimin Nr. 15/62 i datës 23.02.2022, plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 04/90 i datës 26.07.2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ndarje të mjeteve buxhetore në vlerë prej 18,000,000 € (tetëmbëdhjetë milion) euro, në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14.07.2021, i plotësuar dhe ndryshuar, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, në kuadër të masës 2.5 – Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi “Programi i Ringjalljes Ekonomike” me kod 29300, kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere” dhe transferohen në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kod 203, në nën programin “Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve” me kod 40100, në kategorinë e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”.
3. Mjetet sipas këtij vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) te organizata buxhetore dhe programit përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 25/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2021.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 26/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit për zbatimin e projekteve të infrastrukturës, në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi.
2. Përgjatë negociimit të këtij Memorandumi, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të Republikës së Kosovës, obligohet të procedoj në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe akteve tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 27/96
Datë: 14.09.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Planin i Veprimit 2022-2024.
2. Struktura përgjegjëse për koordinimin e procesit të barrës administrative dhe zbatimin e Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Planit të Veprimit 2022-2024, caktohet Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Në kuadër të ZPS caktohet Koordinatorin i procesit të barrës administrative.
3. Obligohet Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, në koordinim me MBPZHR, MMPHI, MPB dhe MSH, të finalizojë plotësimet dhe ndryshimet e të gjitha projektligjeve dhe projekt-akteve nënligjore, sipas shtojcës 1 dhe 2 të Programit, për thjeshtimin e lejimeve për MBPZHR, MMPHI, MPB dhe MSH.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe ministritë tjera, që gjatë ndarjeve buxhetore për vitin 2023, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Zyrës për Planifikim Strategjik, të ndajnë buxhetin e nevojshëm për thjeshtimin dhe digjitalizimin e shërbimeve administrative, në kuadër të mandatit të tyre.
5. Zyra e Kryeministrit obligohet që të marrë masat e nevojshme për sigurimin e kapaciteteve për zbatimin e Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Planit të Veprimit 2022-2024.
6. Obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse të zbatojnë Programin për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Planin e Veprimit 2022-2024.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 28/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 25 të Ligjit Nr. 05/L -081 për Energjinë, Vendimit të Qeverisë Nr. 21/94 të datës 24.08.2022, Vendimit të Kuvendit Nr.1800/3 të datës 09.08.2022 për miratimin e Vendimit Nr. 01/91 të datës 31.07.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

V E N D I M

Masat detyruese për kursim të energjisë në institucione të nivelit qendror, lokal dhe ndërmarrje publike:

1. Të zëvendësohen poçat standard në poça LED në të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal si dhe në ndërmarrjet publike;
2. Të ndalet ngrohja në ato zyre apo objekte ku nuk ka prezencë fizike, si dhe në të gjitha korridoret;
3. Të ndalet ngrohja e ujit në objektet e institucioneve publike (ndalimi i përdorimit të bojlerëve), përveç në institucione si spitalet dhe entitetet e ngjashme, ku uji i ngrohtë është i domosdoshëm;
4. Në rastet ku uji i ngrohtë është i domosdoshëm, obligohen institucionet e nivelit qendror dhe lokal, si dhe ndërmarrjet publike të bëjnë mirëmbajtjen dhe pastrimin/ndërrimin e ngrohësve të ujit;
5. Të ndalen pajisjet elektrike (pajisjet e teknologjisë informative, etj.) në rastet kur nuk përdoren për një periudhë më të gjatë se 10 minuta;
6. Të ndalohet përdorimi i klimave (kondicionerëve) përveç në rastet kur nuk ka alternativa tjera për ngrohje;
7. Të ndalohet përdorimi i ngrohësve omik (ngrohësve me energji elektrike);
8. Të mos përdoret ndriçim në hapësira të brendshme dhe zyrat e objekteve publike gjatë periudhës kur ka dritë të mjaftueshme natyrore;
9. Të ndalet çdo billboard apo reklamë që shfrytëzon energjinë elektrike;

10. Të ndalet ndriçimi dekorativ në të gjitha objektet;
11. Aty ku është e mundshme të instalohen sisteme inteligjente për menaxhimin e konsumit të energjisë (si dritat me senzore, valvulat termostatike, etj);
12. Objektet të cilat ngrohen përmes sistemeve të ngrohjes qendrore të funksionalizojnë potencialin e ngrohjes maksimalisht në dimër duke ndërmarrë hapa të mirëmbajtjes dhe pastrimit të sistemit;
13. Të bëhet sanimi i rrjedhjeve të ujit për zvogëlimin e shpenzimit të energjisë elektrike;
14. Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit të nivelit qendror dhe lokal dhe Zyrtari Kryesor Administrativ i ndërmarrjes publike të caktojë brenda institucionit një person përgjegjës për kursim të energjisë;
15. Personi përgjegjës i caktuar sipas pikës 14 të këtij Vendimi, ka përgjegjësi:
 - 15.1. Të ndalë të gjitha dritat dhe pajisjet elektrike pas orës 16:00;
 - 15.2. Të ndalë të gjithë ndriçimin i cili nuk është i domosdoshëm për siguri fizike të objektit gjatë natës;
 - 15.3. Të sigurohet që gjatë orarit të punës prej orës 08:00 deri në 16:00, temperatura për ngrohjen e hapësirave të jetë jo më shumë se 19 gradë;
 - 15.4. Të sigurohet që pas orës 16:00 deri të nesërmen në ora 07:00 temperatura e ngrohjes të zbritet në minimum (kur ngrohja bëhet me energji elektrike) në rastet kur është e mundshme;
 - 15.5. Të sigurohet që të gjitha dritaret e objektit janë të mbyllura.

Masat detyruese për ndriçimin publik

1. Të ndalohet i gjithë ndriçimi publik gjatë periudhës së ditës kur ka dritë të mjaftueshme natyrore.
2. Të ndalohet i gjithë ndriçimi dekorativ në hapësira publike.
3. Të minimizohet (ndalet çdo e treta llambë) ndriçimi publik në autostrada dhe rrugë regjionale deri në masën e domosdoshme për aq sa nuk përbën rrezik për sigurinë e qytetarëve dhe funksionimin normal të komunikacionit.
4. Të ndalet ndriçimi në hapësirat e monumenteve historike, lapidarëve dhe muzeve, për aq sa nuk përbën sigurinë fizike të objektit.

Zbatimi

1. Obligohet Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit të nivelit qendror dhe lokal dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes publike në përmbushjen e këtyre masave për kursim të energjisë.
2. Obligohet personi përgjegjës për kursim të energjisë, që çdo ditë pas përfundimit të orarit të punës të plotësoj formularin përmes të cilit tregon kontrollin rreth zbatimit të masave për kursimin e energjisë dhe të njëjtin të ja dorëzoj Udhëheqësit të Departamentit/Njesisë përkatëse për Administratë.

3. Obligohen të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal si dhe ndërmarrjet publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë